

# INFORMACIONE



## KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

### PASQYRA E AKTIVITETEVE TE MUAJIT GUSHT

2 Gusht 2004	KOKSH & TVSH <i>Shoë Televiziv për nder të Olimpistëve në « House of Arts »</i>
5 Gusht 2004	Delegacioni Olimpik nisët për në Fshatin Olimpik „Athina 2004“
11 Gusht 2004	Flamuri Shqiptar ngrihet në Fshat/ Ceremoni e Mirëseardhjes
12 Gusht 2004	Kryeministri Fatos Nano pret Delegacionin Olimpik në Ambasadën Shqiptare në Greqi
13 Gusht 2004	Shqipëria në Ceremoninë e Hapjes së Lojrat Olimpikë
16 Gusht 2004	Starton Konkurimi i sportistëve Shqiptarë në Olimpiadë
19 Gusht 2004	Në konkurim Peshëngritje <i>Theoharis Trasha</i> dhe Not <i>Kreshnik Gjata</i>
20 Gusht 2004	Në konkurim Not <i>Rovena Marku</i> dhe Atletikë <i>Dorian Çollaku</i>
21 Gusht 2004	Në konkurim Atletja e 400m/p <i>Klodiana Shala</i>
27 Gusht 2004	Në konkurim Mundësi Sait <i>Prozreni</i> / mbyll përfaqësimin e Shqipërisë
30 Gusht 2004	Delegacioni Olimpik kthehet në Shqipëri nga L.O. « Athina 2004 »

# GUSHT 2004

## NJË MATERIAL I TËRË FOKUSUAR MBI EDICIONIN E 28TË TË LOJRAVE OLIMPIKE « ATHINA 2004 » DHE PËRFAQËSIMIT TË SHQIPËRISË NË KËTO LOJRA.

### 2 Gusht KOKSH & TVSH

Shoë Televiziv në “House of Arts” KOKSH në bashkëpunim me TVSH organizoi një mbrëmje spektakël për nder të Delegacionit Olimpik Shqipëtar që do të përfaqësohet në Lojrat Olimpikë Verore « Athina 2004 ». Me praninë e pjesëtarëve të Delegacionit si edhe të ftuarve të tjerë, ky show përbënte një mundësi më të madhe të njohjes me sportistët tanë dhe të mesazhit Olimpik, për në “Athina 2004”.

### 5 Gusht Skuadra Olimpikë nisët për në Fshatin Olimpik / Greqi

Mbas një grumbullimi dy javor i sportistëve dhe trainerëve pjesmarrës në L.O. « Athina 2004 », Skuadra Olimpikë lë Hotel Bonin ku ishin të akomoduar dhe drejtohet në zyrat e KOKSH ku për ta ishte organizuar një pritje nga anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të KOKSH dhe më pas do të drejtoheshin për në Rinas ku destinacioni i tyre do të ishte Athina dhe më saktë Fshati Olimpik që është ngritur enkas për sportistët e të gjitha vendeve të Botës. Ndër të tjera z. Domi Presidenti i KOKSH dhe z. S. Bello uruan sportistët për një përfaqësim dinjitoz në këto lojra nga ana e tyre dhe u rikujtuan misionin që kjo skuadër mbart për të qënë diplomatët më të mirë të vendit të tyre.

### 12 Gusht Flamuri Shqiptar ngrihet në Fshatin Olimpik

Në ceremoninë e Mirëseardhjes në Fshatin Olimpik, ku kryetari i Bashkisë i dorëzoi shefit të Misionit simbolin e mirëseardhjes për ekipin Shqiptar, Delegacioni Olimpik Shqiptar ka përjetuar me emocione ngritjen e Flamurit Shqiptar në Fshatin Olimpik në Athinë të pranishëm në ceremoni ishin z. Bashkim Zeneli Ambasador i Shqipërisë në Greqi, përfaqësues të artit dhe kulturës, gazetarë gjithashtu dhe përfaqësues të shoqatave të emigrantëve.

### 12 Gusht Kryeministri Fatos Nano pret Delegacionin Olimpik në Ambasadën Shqiptare në Greqi

Ambasada Shqiptare në Greqi ishte vendi i pritjes së Delegacionit Olimpik një ditë para çeljes së Lojrave të 28-ta Olimpikë « Athina 2004 ». Në këtë takim ishin të pranishëm z. Fatos Nano Kryeministër i Shqipërisë dhe ministrat. A. Malaj, A. Angjeli dhe B. Klosi. Pas fjalës përshëndetëse të z. B. Zeneli Ambasador, z. Nano përshëndeti KOKSH për punën serioze të bërë dhe gjithashtu uroi edhe sportistët në një përfaqësim sa më të mirë për vete dhe për Shqipërinë. Më pas Presidenti i KOKSH z. Domi vlerësoi dhe falenderoi njëkohësisht këtë takim të anëtarëve të qeverisë. Gjithshtu z. Domi falenderoi edhe ambasadorin e Shqipërisë në Greqi për gadishmërinë e tij dhe një falenderim të veçantë për sponsorin zyrtar të KOKSH. Takimi u mbyll me një fotografi të përbashkët.

### 13 Gusht Ceremonia e Hapjes së Lojrave Olimpikë

Në një ceremoni madhështore dhe tërësisht spektakolare me elemnetët unikë të mitologjisë, kulturës dhe artit grek, startoi në 13 gusht ceremonia e mrekullueshme e hapjes së *Lojrave Olimpikë « Athina 2004 » - Edicioni i 28-të.*

*Shqipëria përakaloi ashtu si të gjithë 202 shtetet e tjera pjesëmarrëse në Lojrat Olimpikë, e renditur e 12<sup>o</sup>, sipas rendit të alfabetit grek të shkronjave, aprovuar nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar.*

Sipas protokollit zyrtar të hapjes së Lojrave Olimpikë, delegacionet e të gjitha shteteve parakalojnë dhe përshëndesin pjesmarrjen e tyre në këtë eveniment. Flamurtari i Delegacionit tonë Olimpik ishte atletja e 400m/p sportistja Klodiana Shala, e cila ishte e vetmja sportiste nga ekipi ynë Olimpik, që merrte pjesë për herë të dytë në Olimpiadë.

Përbërja e Delegacionit nga :

*Zyrtarë :*

**Hysen Domi** – President i KOKSH

**Stavri Bello** – Sekretar i Përgjithshëm

KOMITETI OLIMPIK KOMBETAR SHQIPTAR

Informacion Mujor – Gusht 2004



Fidel Ylli – Shef Misioni  
Vladimir Gjoni – Staf Administrativ  
Elda Gjoka - Staf Administrativ

**Sportistë :**

Theoharis Trasha – peshëngritje  
Gerti Trasha – peshëngritje  
Sahit Prizreni – mundje  
Klodiana Shala – atletikë  
Dorian Çollaku – atletikë  
Rovena Marku – not  
Kreshnik Gjata – not  
Vaso Selenica – trainer/atletikë  
Kydrete Kozmaj – trainere/not  
Dian Deykov – trainer/peshëngritje  
Taulant Stërmasi – trainer/atletikë  
Gjergji Kokoneci – Doktor

**Kampi Olimpik Rinor :**

Rubena Sukaj  
Endrit Hysenagolli

---

**16 Gusht « Athinë 2004 » Starton Konkurrimit  
PESHËNGRITJE – Gerti Trasha**

Ishte konkurrimi i parë i sportistëve të Ekipit Olimpik Shqiptar Peshëngritësi nga Elbasani Gerti Trasha i cili ka konkuruar në baterinë (B) në peshën 62 kg. Megjithëse sportisti më vogël i Olimpiadës në disiplinën e peshëngritjes, G. Trasha ka zënë vendin e tetë me 255kg në dy garësh në baterinë e tij dhe i 13-ti në renditjen e përgjithëshme.

---

**19 Gusht  
PESHËNGRITJE Theoharis Trasha – 77 kg  
NOT Kreshnik Gjata – 50 m Stil i Lirë**

Theoharis Trasha/peshëngritje dhe Kreshnik Gjata/not konkuruan sot në disiplinën e tyre respektive në L.O. « Athina 2004 ». Trasha konkuroi në baterinë B në peshën 77kg dhe u rendit i treti në këtë bateri me 342.5kg të ngritura në dygarësh. Për 20 gramë trupore më shumë, sportisti ynë nuk arriti të marrë vendin e dytë. Në renditjen përfundimtare u rendit i 13-ti.

Ndërsa sportisti tjetër notari Kreshnik Gjata ka konkuruar në 50m stil i lirë në baterinë e tretë me 8 notarë pjesëmarrës i cili zuri vendin e katërt të kësaj baterie me kohë 00:26.61 dhe duke e përmirësuar rezultatin e tij më të mirë me 3 të qindat e sekondës. Në renditjen përfundimtare notari K. Gjata u rendit i 66-ti nga 83 notarë pjesëmarrës.

---

**20 Gusht  
NOT Rovena Marku 50m Stil i Lirë  
ATLETIKË / Hedhje Çekiçi Dorian Çollaku**

Sipas kalendarit të përcaktuar ka qënë dita e konkurimit të dy sportistëve tanë në L.O. « Athina 2004 », notarja Rovena Marku dhe atleti i hedhjes së

çekiçi Dorian Çollaku. Notarja Rovena Marku ka konkuruar në 50m stil i lirë në baterinë 3. Është renditur e 6-ta në këtë bateri ndër 8 sportiste të vendeve të tjera me kohë 0:30.51 ku ka arritur vetëm të thyej rekordin kombëtar të të rejave dhe në renditjen përfundimtare u rendit e 60-ta ndër 73 sportiste konkurrese.

Sportisti atleti Dorian Çollaku nuk arritur të realizojë rezultatin e tij më të mirë 74.41m i cili i dha kualifikimin në Olimpiadë. Hedhja më e mirë e tij në këtë konkurim ishte 70.06m rezultat i cili e rendit në vendin e 31 të renditjes së përgjithëshme.

---

**21 Gusht  
Atletja e 400m/p Klodiana Shala në konkurim**

Në disiplinën e 400m/p atletikë ka konkuruar sportistja Klodiana Shala duke dhënë një rezultat jo të kënaqshëm për pretendimet e saja në këto lojra. Megjithëse synonte të kapte kohën 55 sekonda ajo arriti të përfundojë këtë konkurim me kohën 1min e cila nuk i dha mundësinë për të vazhduar në turin vijues të konkurimit.

---

**27 Gusht 2004 « Athinë 2004 »  
MUNDJE Sait Prizreni / Mbyll përfaqësimin  
e konkurimit të Ekipit Olimpik**

Sahit Prizreni, ishte sportisti i fundit i Ekipit Olimpik Shqiptar i cili konkuroi në disiplinën e Mundjes së lirë. Prizreni zhvilloi dy ndeshje ku në të parën me mundësin grek u paraqit shumë mirë duke qënë në avantazh me 1 pikë deri 20 sek para përfundimit të ndeshjes. I dekurajuar nga gjykimi jo profesional i gjyqtarëve të ndeshjes së parë Prizreni nuk pati më motivin për të konkuruar denjësisht dhe ndeshja e dytë ishte thjesht një formalitet me sportistin nga Irani. Në renditjen përfundimtare u rendit në vendin e 17-të. Ky ishte edhe konkurimi i fundit i sportistëve të Ekipit Olimpik Shqiptar në Lojrat e 28-ta Olimpikë të « Athina 2004 ».

---

**30 Gusht 2004 Delegacioni Olimpik kthehet  
nga L.O. « Athina 2004 »**

Delegacioni Olimpik Shqiptar lë fshatin Olimpik, dhe pas mbërritjes në Aeroportin Venizelos së Athinës, fluturon drejt Rinasit për tu kthyer në Atdhe.